

MIRË SE VINI!

Fillimi i shkollës fillore

Shkolla fillore organizohet në pesë klasa sipas moshës së fëmijës.: klasa përgatitore (CP) nga moshja 6 deri në 7 vjeç; klasat fillestare viti i parë dhe i dytë (CE1 nga moshja 7 deri në 8 vjeç dhe CE2 nga moshja 8 deri në 9 vjeç), klasat e ndërmjetme viti i parë dhe i dytë (CM1 nga moshja 9 deri në 10 vjeç dhe CM2 nga moshja 10 deri në 11 vjeç).

Cdo klasë ka në dispozicion një **mësues përgjegjës** me të cilin mund të flisni me besim më të plotë. Mos hezitoni t'i bëni atij pyetjet që u duken të rëndësishme. Ju informoheni për ecurinë dhe progresin e fëmijës tuaj si dhe për vështirësitë e tij përmes një evidence shkollore ("livret scolaire").

Në shkollën fillore, çdo mungesë apo vonesë duhet të jetë e justifikuar dhe oraret duhet të respektohen.

Në shkollën fillore, fëmija juaj mëson të lexojë, të shkruajë dhe të përllogarisë. Ai studion gjithashtu shkencat, teknologjinë, historinë dhe gjeografinë. Ai bën muzikë dhe sport. Fëmija shkon në pishinë. Ai përdor kompjuterin. Të gjitha këto veprimtari janë të rëndësishme për zhvillimin e tij. Ato janë të detyrueshme.

Zotërimi i gjuhës frënge nga fëmija juaj, konsiderohet si një prioritet pasi ajo i mundëson atij të mësuarin e të gjitha lëndëve të tjera. Të gjithë të rriturit në shkollë tregojnë kujdes dhe ndihmojnë fëmijën për zotërimin e gjuhës frënge. Nga ana juaj, ju mund të kontribuoni duke e regjistruar fëmijën në aktivitete sportive, kulturore dhe sociale që organizohen në lagjen tuaj të banimit.

Njohuritë dhe kompetencat e përbashkëta i japin fëmijës tuaj njohuri, kompetenca, vlera dhe qëndrime, të cilat janë të rëndësishme për të në realizimin e arritjeve në shkollë, në jetën e tij personale të qytetarit të ardhshëm.

Evidenca individuale e kompetencave ju mundëson të ndiqni progresin e çdo nxënësi.

Provime për njohuritë dhe kompetencat e nxënësve zhvillohen në CE1 dhe CE2.

Fëmija juaj mund të përfitojë edhe nga **orë suplementare të personalizuar** nga të cilat ai përparon në mësimet sidomos në gjuhën frënge. Fëmijës tuaj i propozohen kurse për përmirësimin e nivelit: një javë gjatë pushimeve verore.

Në shtëpi, në mbrëmje, pyeteni fëmijën tuaj se çfarë ka bërë në shkollë, çfarë ka mësuar dhe çfarë duhet të përgatisë për të nesërmen; komunikoni me të.

Mbështeteni fëmijën tuaj: tregoni kujdes për çfarë ai mëson, çfarë ai tregon për shkollën e tij të re, në këtë vend të ri.

Ju mund të takoni mësuesin e fëmijës tuaj ose drejtorin e shkollës fillore.

Fëmija im rritet duke dëgjuar disa gjuhë, a është ky një problem ?

Nuk është problem !

- Është vërtetuar se një fëmijë mund të mësojë lehtësisht disa gjuhë pa i ngatërruar ato.
- Dy në të njëjtën kohë, dy njëra pas tjetrës, tre ose më shumë... çdo gjë është e mundur !
- Duhet thjesht të lini fëmijën të zhvillojë gjuhën me ritmin e tij, ashtu si çdo fëmijë tjetër.

Po çfarë do të ndodhë në shkollë ?

Mos u shqetësoni !

- Më e rëndësishmja është që fëmija të ndjejë që të gjitha gjuhët të jenë të mirëpritura !
- Vazhdoni t'i flisni fëmijës në gjuhën tuaj, tregoni interes për gjuhën ose gjuhët e shkollës dhe për botën e re që fëmija po zbulon !
- Kur fëmija ndihet i sigurt, mësimi i gjuhëve të tjera është më i lehtë për të...ai/ajo mund të bëhet dygjuhësh apo madje dhe shumëgjuhësh !